


EKSPOZITA E IKONAVE
EPARHIA E HORËS SË ARBÈRESHËVE

PALERMO - PALAZZO ARCIVESCOVILE
6 DHJETOR 1980 - 6 JANAR 1981



Hora e Arbëreshëve është Kisha që përbledh në Sicili të krishterët të ardhur nga Lindja gjatë emigracioneve të shekullit XV në ishullin tonë dhe të cilët u mbetën besnikë ritit dhe kulturës së tyre.

Sicilianë në thë gjitha, edhe sot e kësaj dite – ndodhje kjo e vetme në traditën mijëvjeçare të përkulturimit sicilian – ata janë

edhe në të gjitha Arbëreshë. Ata kanë rimarrë në dorë traditën bizantine në Sicili dhe po e mbajnë akoma të gjallë. Arbëreshët e Eparrhisë së Horës së Arbëreshëve sot janë vendosur në katundet: Piana degli Albanesi, Mezzojuso, Palazzo Adriano, Contessa Entellina, S. Cristina Gela. Shumë Arbëreshë banojnë edhe në Palermo.



Shën Mëria Odigjitrie - Prifti Kallogjer Giovannicio.
Gjysma e dytë e shek. XVI

Kisha e madhe e tyre gjendet në Horën e Arbëreshëve; në Palermo ata kanë kishën bashkë-katedrale të Shën Mërisë të Admiralit të ashtuquajtur la Martorana.

Ikonat e Eparhisë.

Është e pranishme në këtë ekspozitë pjesa më kuptimplate e pasurisë ikonografike të Eparhisë

e përbërë me dashuri e me zell gjatë shekujve për t'u përgjigjur kërkesavet teologjike dhe liturgjike të ritit bizantin.

Pas një pune të hollë dhe të brishtë, e cila sapo ka filluar, dolli në dritë një sasi e madhe figurash me bukuri dhe rëndësi të papritura. Disa nga këto ikona janë krejt të panjohura sepse tani po u pastruan nga larzimet që i mbullo-

nin dhe i fshihnin aq sa kishin rënë në harresë.


Do të ekspozohen pala e madhe e Shën Kollit, një kryevepër veneto-kreteze, kryqi i picturuar në të dyja anët, i artit kretez, ikonat me cilësi të lartë që vjinë nga ikonostazat e ndërtuara gjatë shekullit XVI në kishat e ndryshme të Eparhisë. Për herë të parë mund të sodiset, pastaj, seria e madhërishme e ikonave të priftit kallogjer Giovannicio, të cilin eksposita po e dëfton si njërin nga ikonografët grekë më të

shkëlqyer që kanë vepruar në kufijtë e traditës bizantine të thjeshtë në perëndimin e shkëlqimit të saj.

Eparhia e Horës me këto ikona vë në dukje traditën e tërë që e lidh me botën bizantine dhe shqiptare, me ardhjen dhe me praninë e bijve të saj në Sicili, dhe po e lidh veten dhe Sicilinë me botën lindore të djeshme dhe të sotme, me bindje vëllazërore askurrë të shuar dhe me dobi njësimi gjithmonë të dëshiruar.



Deisis. Kret. Fundi i shek. XVII



Krishti duke bekuar.
Kreteze. Shek. XVI

"Ikona është forma figurative e artit lindor të krishterë.


E teorizuar nga Etërit e Kishës dhe e vendosur nga Koncilët ekumenikë, ikona duhet të shërbente si rregull përtërë krishterimin, i cili kështu po pajisej me një art të shenjtë analog me atë të feve të tjera të mëdha. Më vonë në perëndimin kjo traditë po u zhduk, por ajo vazhdon edhe sot të jetë madhështi e lavdi e krishterimit lindor.

Ikona nuk është interpretim i një teme fetare, as dokument i një përvoste personale, as kërkim formal vijash dhe ngjyrash. Mund të gjenden edhe këto të gjitha në të, por ikona ekziston kryesisht për të njoftuar realitetë të

padukura me anë të tē dukuravet. Dhe këtë qëllim e kryen duke ndjekur rregulla artistike që janë forma e përbërje të mbajtura sikur të kishin prejardhje hyjnore dhe të transmetuara nga mjeshtri te nxënësi.

Këto rregulla kanë fuqi të shndërrojnë realitetin e rëndomtë duke e përkulur nën pushtetin shpirtëror: kur po e patën lartësuar në këtë mënyrë, ata po e mbërberthejnë në struktura të padhunueshme.

Gjithashtu këto rregulla me aftësinë e tyre për të harmonizuar, garantojnë dobinë e këtij arti të shenjtë, si dhe vërtetësinë e tij përmbi nivelet e ndryshme të qenies.



Nën brojtjen e

Presidenza della Regione Siciliana
Assessorato Regionale Beni Culturali e Ambientali e
Pubblica Istruzione
Assessorato Regionale del Turismo, delle Comunica-
zioni e dei Trasporti
Assessorato al Turismo, Sport e Spettacolo della Pro-
vincia di Palermo
Azienda Autonoma di Soggiorno e Turismo di Palermo
e Monreale
Banche e Istituti di Credito operanti in Sicilia
Camera di Commercio della Provincia di Palermo
Comune di Palermo
Comuni Italo-Albanesi di Sicilia
Comunità Montane di Corleone e Monreale



KOMITETI ORGANIZUES

Associazione Culturale Italiana per l'Oriente Cristiano
Associazione "Gli Italo-Albanesi di Sicilia"
Cattedra di Lingua e Letteratura Albanese dell'Uni-
versità di Palermo
Centro Internazionale di Studi Albanesi
Clero e Comunità religiose dell'Eparchia di Piana
degli Albanesi
Commissione Regionale per l'Ecumenismo
Curia Arcivescovile di Palermo
Facoltà di Lettere e Filosofia dell'Università di Palermo
Istituto Teologico "S. Giovanni Evangelista"

SEKRETARIA E EKSPOZITËS

Associazione "Gli Italo-Albanesi di Sicilia"
Corso Pisani, 79 - 90129 Palermo - Tel. 423684

*Ekspozitën e Kujdesuan profesorët John Lindsay Opie
e Michel Berger.*



"Epi si cheri". Detal. - Moskos. Gjysma e dytë e shek. XVII
Kryq. Detal. - Kret. Gjysma e dytë e shek. XVII
Shën Joan Pagëzori. Detal. - Kret. Fundi i shek. XVII